REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e martë, datë 10.11.2026, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Armela	**KRASNIQI**	**Kryetar**
Desada	**METAJ**	**Zëvendëskryetar**
Aurela	**BICJA**	**Anëtar**
Besian	**ZOGAJ**	**Anëtar**
Gjergji	**HAMITI**	**Anëtar**
Jetmir	**HALILAJ**	**Anëtar**
Joana	**ALLUSHI**	**Anëtar**

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Pranimin e kërkesës së subjektit person fizik Milika Nito, duke kaluar të drejtat dhe detyrimet e autorizimit për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve "TV Kabllor Ura Vajgurore", tek shoqëria "Nito Group" sh.p.k, me afat vlefshmërie deri në datën 22.12.2028.**(Vendim nr. 124, datë 10.11.2026)**
2. Rinovimin e autorizimit të shoqërisë "4 Plus Media Group" sh.p.k., për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv, mbështetur në rrjet kabllor "TV 4+", për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.**(Vendim nr. 125, datë 10.11.2026)**
3. Miratimin e Rregullores "*Për Përcaktimin e Procedurave dhe Kritereve për Kontraktimin e Pagesën e ekspertëve të Pavarur apo Shërbimeve të tjera Ndihmëse dhe Mënyra e Pagesës*". **(Vendim nr. 126, datë 10.11.2026)**

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 10 nëntor 2026